

# Platforma për të Drejtat e Njeriut

## Constitutional Articles: Liria e Asociimit

1. Liria e asociimit është e garantuar. Liria e asociimit ngërthen të drejtën e secilit për të themeluar një organizatë pa pasur nevojë të sigurojë leje, për të qenë ose për të mos qenë anëtar i një organizate, si dhe për të marrë pjesë në aktivitete të një organizate. 2. Liria për të themeluar sindikata dhe për t'u organizuar, me qëllim që të mbrohen interesat, është e garantuar. Kufizimi i kësaj të drejte mund të bëhet me ligj për kategori të veçanta të punonjësve. 3. Organizatat ose aktivitetet që kanë për qëllim cenimin e rendit kushtetues, shkeljen e lirive dhe të drejtave të njeriut, ose nxitjen e urrejtjes racore, kombëtare, etnike a fetare, mund të ndalohen me vendim gjyqësor të gjykatës kompetente.

## Constitutional Paragraph: Neni 44 para 2

Liria për të themeluar sindikata dhe për t'u organizuar, me qëllim që të mbrohen interesat, është e garantuar. Kufizimi i kësaj të drejte mund të bëhet me ligj për kategori të veçanta të punonjësve

### Instrumentet ndërkombëtare

Pakti Nderkombëtar për të Drejtat civile dhe Politike

Pakti Nderkombëtar për të Drejtat civile dhe Politike

### Nenet

Neni 22

1. Secili person ka të drejtë të bashkohet lirisht me të tjerët, duke përfshirë të drejtën për të formuar sindikata dhe për të marrë pjesë në të mbrojtjen e interesave të veta.

2. Ushtrimi i kësaj të drejte mund të jetë objekt vetëm i kufizimeve që parashikohen me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë kombëtare, qetësisë dhe rendit publik, ose për të mbrojtur shëndetin ose moralin publik apo të drejtat dhe liritë e të tjerëve. Ky nen nuk ndalon kufizimet ligjore për ushtrimin e kësaj të drejte nga antarët e forcave të armatosura dhe të policisë.

## Instrumentet ndërkombëtare

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj  
Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj

Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare  
Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare

## Ligjet

Ligji i Punës Nr. 03/L-212  
Ligji i Punës Nr. 03/L-212

LIGJI Nr. 04/-L-011  
PËR ORGANIZIMIN  
SINDIKAL NË  
KOSOVË  
LIGJI Nr. 04/-L-011  
PËR ORGANIZIMIN  
SINDIKAL NË  
KOSOVË

## Nenet

### Neni 11

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të organizimit me të tjerët, duke përfshirë të drejtën e themelimit me të tjerë të sindikatave dhe të pjesëmarrjes në to për mbrojtjen e interesave të tij.  
2. Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk mund t'u nënshtrohet kufizimeve të tjera përveç atyre që parashikohen me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve. Ky nen nuk ndalon kufizime të ligjshme të ushtrimit të këtyre të drejtave nga pjesëtarë të forcave të armatosura, të policisë ose të administratës shtetërore.

### Neni 8

Palët angazhohen të pranojnë se çdo person që i përket një pakice kombëtare ka të drejtën të manifestojë fenë apo besimin e tij/saj dhe të krijojë institucionet, organizatat dhe shoqatat fetare.

## Nenet

### Neni 88

1. Të punësuarve dhe punëdhënësve u garantohet liria e asocimit dhe veprimit pa ndërhyrje nga asnjë organizatë ose organ publik;

### Neni 6

1. Të punësuarëve i'u garantohet liria e organizimit dhe veprimit sindikal. 2. Sindikatat themelohen për mbrojtjen e të drejtave të të punësuarëve dhe lirive sindikale. 3. Të punësuarit kanë të drejtë në bazë të vullnetit të lirë, të themelojnë sindikatën dhe të anëtarësohen në të, sipas kushteve të cilat janë të përcaktuara me këtë ligj dhe statut . 4. Organizatat sindikale kanë të drejtë, që aktivitetin e tyre ta realizojnë në pajtim me aktet normative, të zgjedhin vullnetarisht përfaqësuesit e tyre, të organizojnë administratën, të zhvillojnë aktivitetet sindikale dhe të hartojnë programe sindikale.

**Ligjet**

Ligji nr. 08/1-197 për  
zyrtarët publik  
Ligji nr. 08/1-197 për  
zyrtarët publik

**Nenet**

Neni 24

Zyrtarja/i publik ka të drejtën e pjesëmarrjes në grevë për të mbrojtur interesat ekonomike, sociale dhe profesionale në pajtim me legjislacionin përkatës për grevat dhe kur kjo lejohet me ligj të veçantë.

**decisionTitle\*****decisionDescription\***

NATIONAL  
UNION OF  
BELGIAN POLICE  
v. BELGIUM

Në këtë rast, sindikata e aplikantit u ankua se Qeveria Belge nuk kishte njohur atë si një nga organizatat më përfaqësuese të cilat Ministria e Brendshme kërkohej me ligj që të këshillohej. Gjykata vendosi që nuk kishte pasur shkelje të nenit 11 të Konventës, duke konstatuar se sindikata e aplikantit kishte mjete të tjera të veprimit përballë qeverise, përveç konsultimeve me Ministrinë e Brendshme. Më tej Gjykata konsideroi se politika e përgjithshme e Belgjikës për të kufizuar numrin e organizatave për t'u konsultuar nuk ishin në vetvete të papajtueshme me lirinë sindikale dhe ishte çështje për diskrecionin e Shtetit.

SWEDISH  
ENGINE  
DRIVERS' UNION  
v. SWEDEN

Sindikata e aplikantëve u ankua për refuzimin e Marrëveshjes Kolektive Kombëtare për të lidhur një marrëveshje kolektive me të edhe pse kishte lidhur nje marrëveshje të tillë me federatat kryesore sindikale.

Gjykata gjeti se nuk ka shkelje te nenit 11 të Konventës: Politika e përgjithshme e Zyrës për të kufizuar numrin e organizatave me të cilat lidhin marrëveshje kolektive nuk ishte e papajtueshme me lirinë e sindikatave. Neni 11 nuk siguron ndonjë trajtim të veçantë të sindikatave si psh e drejta për të lidhur marrëveshje kolektive.

Matelly v. France

Ky rast kishte të bënte me ndalimin absolut të sindikatave brenda armatës franceze. Aplikanti u ankua në veçanti për një ndërhyrje të pajustificuar dhe disproporcionale në ushtrimin e lirisë së tij të bashkimit. Gjykata vendosi se kishte pasur shkelje të nenit 11 të Konventës. Gjeti në veçanti se vendimi i autoriteteve në lidhje me aplikuesin (një urdhër për dorëheqja nga një shoqatë e së cilës ai ishte anëtar) arriti në një ndalesë absolutet të personelit ushtarak që të anëtarësohet në një grup profesioni sindikal, të formuar për të mbrojtur interesat e tyre profesionale dhe jopasurore dhe se bazat për një vendim të tillë nuk ishin të mjaftueshme. Gjykata konkludoi që, ndërsa ushtrimi i lirisë së bashkimit nga personeli ushtarak mund ti nënshtrohet kufizimeve të ligjshme, një ndalesë e tillë për formimin ose anëtarësimin në një sindikatë kishte shkelur thelbin e kësaj lirie.